



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 60/01-15767/21
Kaçanik, 15.06.2021

Mbështetur në nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 59 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të pikës 6 paragrafi 4.3 e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2021, 01Nr. 060/01-28891/20 të datës 23.11.2020, me Ftesën e Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës Nr.03-2183 të datës 07.06.2021, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 15 Qershor 2021, mori këtë:

V E N D I M
PËR REALIZIMIN E NJË VIZITE ZYRTARE TË ANËTARËVE TË KUVENDIT TË
KOMUNËS KAÇANIK, NË KOMUNËN E STRUGËS

1. Me këtë Vendim, vendoset të realizohet një vizitë zyrtare e Anëtarëve (Këshilltarëve) të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Komunën e Strugës, me datë 8 dhe 9 Korrik 2021.
2. Vizita zyrtare nga pika 1. e këtij Vendimi, realizohet në bazë të Ftesës së Kryetarit të Këshillit të Komunës së Strugës Resul Kaba, Nr.03-2183 e datës 07.06.2021, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy komunave.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Ftesa Nr.03-2183 e Komunës së Strugës dhe Agjenda e përgatitur nga Shefat e GP në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit.
4. Përgatitjet e nevojshme për realizimin e vizitës do të kujdesen, Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Shefat e GP të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.
5. Shpenzimet për realizimin e vizitës nga pika 1 e këtij vendimi do t'i bartë Komuna e Kaçaniku, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Kryesuesi i Kuvendit;
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK



ОПШТИНА СТРУГА
KOMUNA E STRUGË
№ 03-2483/
02.06.2021
СТРУГА СТРУГЕ

Data	07.06.27	Vendi	KAÇANIK
Org.		Numri	
	09	60/03-	15765

Lënda: Ftese për vizitë zyrtare

Drejtuar: Z. Kemajl Murseli
KRYETARIT TE KUVENDIT TE KOMUNES KACANIK

I nderuar z. Murseli,

Gjej rastin t'ju dërgoj përshendetjet e përzemërta në adresën tuaj.

Më lejoni që nëpërmjet kësaj ftese t'ju ftoj ju dhe këshilltarët e Komunës së Kaçanikut për një vizitë zyrtare në Komunën e Strugës në datën 8 dhe 9 Korrik.

Me anë të kësaj vizite ne mund të shkëmbejmë përvojat si dhe të rrisim bashkëpunimin ndërmjet dy komunave.

Vizita juaj do të ishte një kënaqësi për qytetin tonë.

Jemi duke pritur t'ju takojmë në qytetin tonë të bukur të Strugës, ndaj ju falenderoj për vëmendjen.

Me respekt,

Kryetari i Këshillit të Komunës së Strugës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/03-16859/2021
Kaçanik, 17.06.2021

Lënda : Kërkesë për nisjen e proceduarave të prokurimit për realizimin e vizitës zyrtare në Komunën e Strugës, më datat 8 dhe 9 korrik

Arsyetim : Bazuar në ftesën e Kryetarit të këshillit të Strugës z Resul Kaba drejtuar Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës 07/06/2021 Kuvendi Komunal me datë 15/06/2021 miratoi vendimin për realizimin e vizitës zyrtare në qytetin e strugës më datat 8 dhe 9 korrik 2021.

Realizimi i vizitës do behet sipas itinerarit të përcaktuar nga grupet parlamentare

Itinerari : Nisja nga Kaçaniku më me 8 Korrik, ndërkaq kthimi me 10 Korrik 2021.

Akomodimi dy netë dhe tre ditë. Akomodimi në hotel në Strugë all inkluziv në dhoma maksimum me dy shtretër të ndarë.

Ushqimi i vakteve nga tre racione ditore, përzgjedhja sipas dëshirës (3 mëngjese 3 dreka dhe 3 darka).

Hoteli duhet të posedojë edhe sallë për mbajtjen e aktiviteteve (punëtorive , konferencave , dhe aktiviteteve tjera).

Numri i personave 32

Vizita do të realizohet edhe në qytetin e Pogradecit dhe të Korçës.

